



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme – Ministarstvo Unutrašnjih Poslova – Ministry of Internal Affairs

Kabineti i Ministrit – Kabinet Ministra – Cabinet of the Minister

Nr. 0616 /2024
Datë: 29/11 /2024

Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në mbështetje të nenit 10 paragrafi 2 dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 07, 01 mars 2019), nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr. 34, 18 nëntor 2022), nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës që i kanë regjistruar faktet e gjendjes civile (lindjen, martesën dhe/apo vdekjen) në strukturat jo-legale serbe, nga data 10 Qershor 1999 deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi, kanë të drejtë për aplikim për regjistrim të atyre fakteve në Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile të Republikës së Kosovës.
2. Regjistrimi i fakteve të gjendjes civile sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet duke u bazuar në të dhënat e dokumenteve të dorëzuara nga pala.
3. Për regjistrimin e faktit të lindjes sipas pikës 1 të këtij vendimi njëri nga prindërit e fëmijës duhet të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
4. Në rast se qytetarët, që e gëzojnë të drejtën sipas pikës 1 të këtij vendimi, kanë lidhur martesë me shtetasit e huaj, këta të fundit duhet t'i nënshtrohen dispozitave të ligjit përkatës për të huajt për të fituar shtetësinë e Kosovës përmes procedurës së natyralizimit sipas ligjit përkatës për shtetësinë e Kosovës.
5. Me rastin e aplikimit për regjistrimin e lindjes, kërkesës duhet t'i bashkëngjiten dokumentet si në vijim:
 - 5.1. Kopjet e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës të prindit/prindërve; dhe
 - 5.2. Certifikatën e lindjes origjinale të lëshuar nga strukturat jo-legale serbe, ose fletë-lëshimin nga institucionet shëndetësore.

6. Me rastin aplikimit për regjistrimin e martesës, kërkesës duhet t'i bashkëngjiten dokumentet si në vijim:
 - 6.1. Kopje/t e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës; dhe
 - 6.2. Certifikatën e martesës origjinale të lëshuar nga strukturat jolegale serbe.
7. Me rastin e aplikimit për regjistrimin e vdekjes, kërkesës duhet t'i bashkëngjiten dokumentet si në vijim:
 - 7.1. Certifikatën origjinale; apo
 - 7.2. dëshmi tjetër mbi vdekjen të lëshuar nga strukturat jo-legale serbe.
8. Obligohet Agjencia për Regjistrimin Civil për zbatimin e këtij vendimi.
9. Vendimi hyn në fuqi me datë 1 shkurt 2025 dhe zbatohet deri me datën 30 prill 2025.

Xhelal SVECLA

Ministër
Ministria e Punëve të Brendshme



Vendimi i dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Drejtorit të Përgjithshëm të ARC-së;
- Departamentit Ligjor në MPB;
- Arkivit të MPB-së.